



ÇËSHJTJET KRYESORE:

- RASTI I PËLLUMB MARNIKOLLAJ
- MONITORIMI I ANKESËS SË TË DËNUARIT PËR USHTRIM DHUNË NË IEVP DRENOVË
- NJË AKT I RËNDË DHUNË NË BURGUN FUSHË-KRUJË
- DËNOHET SULMI ME ARMË NDAJ BANESËS SË GAZETARES KLODIANA LALA

NE VUJIM ; 2

NDRYSHIMET NË KODIN ZGJEDHOR KËRKOJNË 2

HELSINKI GREK I DREJTOHET KESHILLIT TE EVROPES PER RASTET E TORTURES 2

LIDHJA E GJYQTAREVE DHE PROKUROREVE ME KRIMIN E ORGANIZUAR 3

MONITORIMI I PROCESIT TË VETTINGUT 3

RAPORT STUDIMOR JANAR—2017—QERSHOR 2018 3

GRUPET VULNERABEL 4

OPERACIONI VOL-VO 4

DISKRIMINIMI I PERSONAVE ME MASË MJEKESORE 4

DITA KOMBËTARE E 4

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

BULETIN

NR. 4

SHTATOR-TETOR 2018

KLINIKA LIGJORE

RASTI I PËLLUMB MARNIKOLLAJ



Komiteti Shqiptar të Helsinkit ju komunikua nga Monitoruesi Grek i Helsinkit se mbarëvajtja e procesit hetimor dhe gjyqësor për zbardhjen e rastit të dyshuar si torturë nga policia greke, karshi shtetasit shqiptar, të ndjerit Pëllumb Marnikollaj nuk është pozitive. Avokatët e familjarëve të të ndjerit, i cili humbi jetën në ambientet e një komisarati policie në shtetin Grek, kanë informuar Monitoruesin Grek të Helsinkit se gjyqtari i çështjes i ngarkuar për të realizuar një hetim gjyqësor penal nuk ndërmori ndonjë veprim hetimor por e ktheu dosjen gjyqësore në prokurori, dy vite më vonë, duke rekomanduar që rasti të arshivohet. KShH, bazuar në këto të dhëna shpreh shqetësimin lidhur me ecurinë e zbardhjes së kësaj ngjarje nga autoritetet e drejtësisë greke, ku shtetasit shqiptarë të dëmtuar apo të dhunuar nga policia, apo familjarët e viktimave të dhunës policore, nuk marrin drejtësinë e merituar. Për më shumë informacion ju lutemi lexoni [ARTIKULL](#)



NJOFTIM PËR SHTYP

KShH dënon fuqimisht sulmin me armë ndaj banesës së gazetares së njohur Klodiana Lala dhe familjarëve të saj. KShH e konsideron këtë si një akt jo vetëm banditesk, por edhe frikacak me synim për të ushtruar presion dhe kërcënim ndaj fjalës së lirë. Gazetaria Klodiana Lala e ka kryer me ndershmëri, integritet dhe guxim misionin e saj si gazetare profesioniste për të marrë informacion dhe për t'ja dhënë atë publikut të gjerë, duke nxitur kështu debatin dhe kritikën, si dhe duke ndihmuar intensifikimin e luftës kundër kriminalitetit. Kritikën e saj ndaj politikanëve dhe përfaqësuesve publikë kanë synuar jo vetëm për të kritikuar çdo veprim të kundraligjshëm, por dhe për të ruajtur figurën e pastër të tyre. Për më shumë informacion lexoni: [ARTIKULL](#)

MONITOROHET ANKESA E TË DËNUARIT PËR USHTRIM DHUNË NË IEVP DRENOVË

Në dt.12 Tetor 2018, ora 10:00 (paradite), i dënuari M.Th i akomoduar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Drenovë, Korçë, njoftoi Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KShH) në rrugë telefonike për ankesën e tij. Sipas të dënuarit, në mbrëmjen e datës 11 Tetor 2018, rreth orës 23:00 (të mbrëmjes), punonjës të grupit të sigurisë pranë këtij burgu kishin ushtruar dhunë fizike ndaj tij. Për më shumë informacion ju lutemi lexoni: [ARTIKULL](#)



NJË AKT I RËNDË DHUNË NË BURGUN FUSHË-KRUJË

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) nëpërmjet medias të datës 31 Korrik 2018 u informua se në Burgun e Fushë Krujës, grupi i gatshëm i policisë së burgjeve kishte ushtruar dhunë ndaj të dënuarit A.L. Për verifikimin e ngjarjes, në datën 1 Gusht 2018, dy përfaqësues të KShH-së kanë shkuar në IEVP Fushë Krujë. Gjatë këtij verifikimi u mor takim me drejtuesin e këtij institucioni, mjekun e burgut, personelin tjetër dhe punonjësit e grupit të gatshëm (grupi i sigurisë), si dhe vetë personin që dyshohej si viktimë e dhunës. Për më shumë informacion ju lutemi lexoni : [ARTIKULL](#)




Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, vendosi lënien në fuqi të Vendimit të dhënë nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, nëpërmjet të cilit u pranua kërkesë-padia e depozituar nga ana e KShH. Ndër të tjera, me anë të këtij vendimi Gjykata është shprehur për detyrimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit për të kryer hetim administrativ dhe për t'u shprehur me vendim lidhur me mosdhënien e informacionit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë mbi procedurën e realizimit të Implantit Koklear. Për më shumë informacion ju lutemi lexoni: [ARTIKULL](#)

NDRYSHIMET NË KODIN ZGJEDHOR KËRKOJNË KONSENSUS DHE SHMANGIE TË FORMALIZMIT NË KONSULTIMIN PUBLIK.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) që më datë 13 Nëntor 2017 ka përshëndetur ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Në deklaraten tonë publike është theksuar nevoja që ky proces të ishte gjithëpërfshirës, cilësor, por jo i vonuar. Pas mbarimit të mandatit 6 mujor të këtij Komisioni dhe shtyrjes së afatit për veprimtarinë e tij, meqë rezultonte se gjatë kësaj kohe nuk ishte arritur asnjë rezultat konkret, me datën 13 Prill 2018, KShH ka reaguar përsëri publikisht duke evidentuar faktin se vonesat për ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor mund të kishin pasoja të dëmshme, sidomos në kushtet kur pragu për përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme vendore në vendin tonë, ishte i afërt. KShH vëren se kanë kaluar mbi 10 muaj nga koha e ngritjes së Komisionit të Reformës Zgjedhore. Është e vërtetë se me aktorë të ndryshëm vendas dhe ndërkombëtarë janë organizuar disa takime konsultative, ku kryesisht janë diskutuar disa modele të vendeve të tjera. Por edhe pas këtyre takimeve nuk është dhënë asnjë njoftim mbi veprimtarinë e Komisionit dhe sidomos nëse për këtë apo atë çështje është arritur konsensus. Kjo edhe për faktin se për miratimin nga Kuvendi të këtyre ndryshimeve kërkohet votim me shumicë të cilësuar. Dje më datë 4 Tetor 2018, Bashkëkryetari i Komisionit të Reformës Z. Bledi Çuçi u ka dërguar disa organizatave të shoqërisë civile (midis tyre edhe KShH-së), draftin e projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor. Ky draft nuk është shoqëruar me relacion shoqërues. Projektligji ka 51 nene me përmbajtje të rëndësishme që kërkon studim të thelluar edhe për faktin se ka ndryshime dhe shtesa të reja dhe të diskutueshme. Për më shumë informacion ju lutemi lexoni: [ARTIKULL](#)

HELSINKI GREK I DREJTOHET KËSHILLIT TË EVROPËS PËR RASTET E TORTURES DHE TRAJTIMIT Ç'NJERËZOR, DUKE PËRFSHIRË EDHE SHTETASIT SHQIPTARË.



Monitoruesi Grek i Helsinkit i drejtohet Presidentit të Këshillit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, duke i kërkuar ndër të tjera ri-hapje të hetimeve për 12 çështje të fituara në Gjykatën e Strasburgut, me të paditur shtetin Grek. Një nga këto raste është Çelniku kundër Greqisë (Iliir Çelniku u vra nga forcat e policisë greke në Nëntor të vitit 2001). Gjithashtu, Komitetit të Ministrave i kërkohet të hetojë vdekjen e shtetasit shqiptar, 28 vjeçarit Pëllumb Marnikollaj, i cili humbi jetën në dt.3 Gusht 2016, në ambjetet e Stacionit të Policisë së Patisias (në rrugën Aghias Lavras në Athinë). Autoritetet policore greke pretenduan dy javë pas ngjarjes (18 Gusht), se i ndjeri Pëllumb Marnikollaj u hodh nga kati i dytë i stacionit të policisë! Gjithashtu, autoritetet nuk informuan askënd nga familjarët e viktimës, të cilët lokalizuan trupin e tij në dt.11 Gusht, në kohën kur do të varrosej si një person i cilësuar si i pa kërkuar.



Ecuria e procesit të vettingut në drejtësi ka rëndësi të veçantë për krijimin e institucioneve të reja, për përmbushjen e detyrimeve kushtetuese e integruese të vendit, për zhblokimin e ngërçeve të krijuara në procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, si dhe për të përmbushur në kohë e me cilësi pritshmëritë e publikut ndaj zbatimit të reformës. Rezultatet pozitive të arritura gjatë muajve qershor – korrik 2018 duke shënuar zhvillimin e një numri të madh seancash dëgjimore dhe numër të lartë vendimmarrjeje pritej të kishin ritëm të njëjtë dhe përmirësime cilësore në fazën e re të subjekteve të tjera të listës prioritare, të rinisur në muajin shtator. Ne, si përfaqësues të shoqërisë civile, konstatojmë me shqetësim se ndryshe nga pritshmëria dhe nevojat e reformës, dy muajt e fundit është vërejtur një ngadalësim i ndjeshëm i procesit të vettingut, në raport me ritmet dinamike që ky proces ka patur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) **Lexo.**



MONITORIMI I PROCESIT TË VETTINGUT

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në kuadër të monitorimit të procesit të Vettingut, nga muaji nëntor dhe në vazhdimësi ka ndarë me publikun gjetjet e monitorimit të seancave dëgjimore me gjyqtarët dhe prokurorët të cilët i nënshtrohen procesit vettingut. Bashkëpunimi i publikut dhe transparenca e procesit karshi publikut është një nga komponentët më të rëndësishëm të vettingut. KShH ju fton të njiheni me skemat e monitorimit të vëzhguesve të KShH-së për subjektet e rivlerësimit kalimtar. Këto subjekte i nënshtrohet vlerësimit me short. Klikoni linkun më poshtë për të parë gjetjet paraprake të subjekteve të monitoruara deri tani dhe në periudhat në vazhdim.

VETTINGU I GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 “Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut” – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

LIDHJET E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE ME KRIMIN E ORGANIZUAR NË KUADËR TË VETTINGUT, DISA NGA SFIDAT E DERITANISHME TË PROCESIT!

Vendimet e para të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) për shkarkimin e disa gjyqtarëve dhe prokurorëve u mbështetën më së shumti në problematikat për kriterin e pasurisë. Deri pak ditë më pare, në vendimet e arsyetuara të KPK-së rezulton se vetëm ndaj një subjekti (vendimi nr.39 për subjektin T.N, gjyqtar në Gjykatën e Lartë) është vendosur shkarkim nga detyra, ndër të tjerash sepse janë vërejtur pasaktësi në plotësimin e formularit për kriterin e pastërtisë së figurës ose siç njihet ndryshe, lidhjet e gjyqtarëve/prokurorëve me persona të përfshirë në krimin e organizuar. **Lexo;**

RAPORT STUDIMOR MONITORIMI I PROCESIT TË VETTINGUT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË PERIUDHËN JANAR—2017—QERSHOR 2018

KShH prezanton disa nga gjetjet kryesore të monitorimit të procesit të Vettingut për periudhën Janar 2017 - Qershor 2018.

RAPORT STUDIMOR



GRUPET VULNERABËL

DISKRIMINIMI I PERSONAVE ME MASË MJEKËSORE, “MJEKIM I DETYRUAR NË NJË INSTITUCION MJEKËSOR” DHE PACIENTËVE ME MASË SIGURIMI “SHTRIM I PËRKOHSHËM NË NJË SPITAL PSIKIATRIK”.

Më datë 19 Tetor 2018, KShH i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet një ankese me objekt: Mbi diskriminimin e personave me masë mjekësore, “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” dhe pacientëve me masë sigurimi “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, të akomoduar në mënyrë të paligjshme në institucionet me natyrë penitenciare. Për më shumë informacion ju lutemi lexoni: [LINK](#)

DITA KOMBËTARE E AKTIVIZMIT

Në kuadër të Ditës Kombëtare të Aktivizmit, KShH realizoi një aktivitet sensibilizues më datë 22 Tetor 2018, ora 11:30, në Fshatin Oficinë e Vjetër (Patos). Ndjekja në rrugë gjyqësore e kësaj çështje realizohet në kuadër të Projektit “Të litigojmë në mënyrë strategjike për mbrojtje efektive të të drejtave në fushën e shëndetit”, mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.



Ju presim
në panair!

22 Tetor

Panairi i
Shoqërisë
Civile
Sheshi “Skënderbej”
Ora 10.00



TRANSPARENCA DHE KUR ËSHTË RASTI, PËRGËNJESHTRIMI I NJË NJOFTIMI APO TË DHËNAVE QË NUK I PËRGIGJEN TË SË VËRTETËS JANË TË DOMOSDOSHME.

Gjatë kryerjes së operacionit “Vol-vo 4” janë kryer një numër i konsiderueshëm ndalimesh dhe arrestimesh. Sipas medias referohet se është arrestuar edhe shtetasja Mimoza Ndoka, e akuzuar për tjetërsim pronash. Sipas njoftimeve të medias, të dt.25 Tetor 2018, prokuroria ka kërkuar për shtetasen M. Ndoka, masë sigurimi “arrest në burg”, ndërsa gjykata ka vendosur masën “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Referuar njoftimeve në media, M. Ndoka është lejuar nga gjykata, në kohën kur do të shqyrtohej masa e sigurimit që ti jepte gji fëmijës së saj. [Për më shumë:](#)

TË LITIGOJMË NË MËNYRË STRATEGJIKE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE NË FUSHËN E SHËNDETIT

Në monitorimin e radhës Komiteti Shqiptar i Helsinkit, vëzhgon ndotjen shqetësuese të lumit Gjanicë. Banorët e Bashkisë Mallakastër dhe Fier e kanë të pamundur që të bashkëjetojnë me aromën e rëndë të naftës dhe mbetjet hidrokarbure e inerte të hedhura në lumin Gjanicë, duke ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës dhe shëndetit të tyre. Në përmbyllje të misionit të tij, KShH do të vijojë me ndjekjen e rrugës gjyqësore të adresimit për zgjidhje të situatës. [Link Video](#)

Ky buletin është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore XII”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze.



Përmbajtja e këtij bulletini është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze ose të organizatës Civil Rights Defenders.

Gjetjet dhe çështjet e publikuara në këtë buletin u mundësuan nga: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Ambasada e SHBA-ve në Shqipëri, Civil Rights Defenders, Komisioni Evropian, Open Society Institute - Budapest, Ambasada e Vendeve të Ulëta në Shqipëri, Ambasada e Britanisë së Madhe, ERRC European Roma Right Community, Komiteti Holandez i Helsinkit, Bank Watch etj.

Adresa: Rr. “Brigada e VIII”, Pall TeknoProjekt, Ap.10, Kati 6 Tiranë-Shqipëri

Kutia Postare Nr. 1752, Tel: ++355 (0)4 233671, e-mail: office@ahc.org.al, web adresa: www.ahc.org.al